

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dënimi nga Haga - Blushi thërret në interpelancë Ramën: Çfarë masash do marrë Qeveria për të rrëzuar aktgjykimin ndaj ish krerëve të UÇK?
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917979/blushi-therret-ne-interpelance-ramen-cfare-masash-d-o-marre-qeveria-per-te-rrrezuar-aktgjykimin-ndaj-ish-krereve-te-uck/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	20 shtator 2026, 12:03:52 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	20 shtator 2026, 11:53:12 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	a2c99b62c2cb84b0f0dc3e3597d482e3aca24c4ac5f8e7b8fae96e372b1ceb09
TEKSTI	bd49fb85c0234e98a1cc90b3dfb3b7ed2e2278856e84ca99c60ac890e7bcb742
PAMJA	a9046936c0f7cc2437bf3449837663aa78fe942d866eb5ee84d19d71362212

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8cf46bd30d2124873b109c1bd5afe155f791f0abbaddcc25a461cfc287b57ad6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	36d3812b75abb32c2d0a144e9d997c17b4f1cdc4fe45cb80665e1d5362027ce4
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8cf46bd30d2124873b109c1bd5afe155f791f0abbaddcc25a461cfc287b57ad6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**ENVER ROBELLI**
Qëndrimi i Zagrebit dhe
heshija e Tiranës**NDRIÇIM KULLA**
Rama dhe Vuçiç, dy vëllezërit
siamezë të dekadencës
demokratike evropiane

më të lexuarat

'Akuza të stisura politikisht', Saiti:
Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të
Kosovës

Takimi sekret i DEA-s me vendet e
Amerikës Latine/ Si po i damkos
shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën
si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani
Konrad Clewing! Faji individual, lufta e
Kosovës dhe kufijtë...

Ligji për statusin e magistratëve të hiqet
nga rendi i ditës, Bardhi denoncon
skandalin: Në Kuvend versioni i ri i
pakonsultuar me asnjë...

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa
fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e
fabrikua në Serbi

Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj
gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën
në derë për aferat ku je zhytur



Blushi thërret në interpelancë Ramën: Çfarë masash do marrë Qeveria për të rrëzuar aktgjykimin ndaj ish krerëve të UÇK?

13:53, 20/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Deputeti i PL, Tedi Blushi ka kërkuar interpelancë me kryeminsitrin Edi Rama, pas dënimit të ish krerëve të UÇK në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit e Jakup Krasniqit, të cilët luftuan për të mbrojtur luftën e UÇK.

Sipas Blushit pas deklaratës unanime të Kuvendit, Shqipëria nuk mund të mjaftohet më me reagimin politik.

Ligjvënësi i PL, thekson ndër të tjera se qëndrimi i Kuvendit duhet të përkthehet në një strategji konkrete shtetërore, juridike dhe diplomatike.

Blushi shton se nga ana e qeverisë shqiptare duhet të ndërmerren veprime konkrete, ligjore, diplomatike, institucionale dhe e mirëkoordinuar me Republikën e Kosovës.

'Republika e Shqipërisë duhet të përdorë të gjitha instrumentet që i njeh e drejta ndërkombëtare për të mbrojtur interesat e saj, për të mbështetur institucionet e Kosovës dhe për të garantuar që çdo çështje që prek drejtpërdrejt Shqipërinë dhe interesin kombëtar, të trajtohet me seriozitetin, ekspertizën dhe përgjegjësinë që kërkon një çështje e kësaj rëndësie', thekson ndër të tjera deputeti i PL, Tedi Blushi në kërkesën për zhvillimin e një interpelance urgjente me Kryeministrin.

KËRKESA:

KUVENDI

Grupi Parlamentar i Partisë së Lirisë

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më 20.09.2026

K Ë R K E S Ë

KËRKUES: Z. Tedi Blushi
Deputet, Grupi parlamentar i Partisë së Lirisë

OBJEKTI: Kërkesë për interpelancë me Kryeministrin, Z. Edi Rama mbi aktgjykimin e Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit dhe masat që duhet të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Shqipërisë

BAZA LIGJORE: Neni 80 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Neni 96 i Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë.

DREJTUAR: Z. Niko Peleshi
Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë.

Z. Kryetar i Kuvendit,

Në mbështetje të nenit 80 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 96 të Rregullores së Kuvendit, kërkoj zhvillimin e një interpelance me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë lidhur me qëndrimin dhe masat konkrete që Qeveria shqiptare do të ndërmarrë pas aktgjykimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

Ky zhvillim nuk mund të trajtohet nga Republika e Shqipërisë si një çështje që u përket vetëm të dënuarve, familjeve të tyre apo institucioneve të Kosovës. Ai ka një dimension të drejtpërdrejtë historik, juridik, politik dhe ndërkombëtar për Kosovën dhe prek edhe interesat e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për shkak të përfshirjes së papranueshme në proces të ngjarjeve dhe vendndodhjeve në territorin shqiptar.

Kuvendi i Shqipërisë e ka përcaktuar tashmë, me deklaratë të miratuar unanimisht, qëndrimin politik dhe institucional të Shqipërisë. Kuvendi ka shprehur indinjatën dhe mosdakordësinë e plotë me aktgjykimin, ka qëndruar në solidaritet të plotë me Kosovën dhe me katër të dënuarit e familjet e tyre dhe ka ritheksuar se lufta e UÇK-së ishte luftë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës, në përgjigje të represionit, dhunës dhe spastrimit etnik të ushtruar ndaj popullsisë shqiptare të Kosovës nga regjimi kriminal i kasapit të Ballkanit, Slobodan Milošević.

Mbi të gjitha, Kuvendi ka bërë një përcaktim të qartë institucional se ky aktgjykim nuk është fjala e fundit dhe të gjitha mjetet juridike dhe shkallët e mëtejshme të procesit duhet të ndiqen deri në fund, duke garantuar respektimin e plotë të standardeve të procesit të rregullt ligjor. Njëkohësisht, Kuvendi u ka bërë thirrje dy qeverive tona të koordinojnë veprimet me qëllim korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale.

Pikërisht këtu qëndron sot përgjegjësia e Qeverisë shqiptare.

Pas deklaratës unanime të Kuvendit, Shqipëria nuk mund të mjaftohet më me reagimin politik. Qëndrimi i Kuvendit duhet të përkthehet në një strategji konkrete shtetërore, juridike dhe diplomatike.

Për këtë arsye, kërkoj që Kryeministri të japë përgjigje konkrete për këto pesë prioritete:

1. VEPRIMI JURIDIK DHE MBËSHTETJA E MJETEVE TË MËTEJSHME LIGJORE

Cilat janë masat dhe veprimet konkrete që Qeveria e Republikës së Shqipërisë synon të ndërmarrë, për të mbështetur ndjekjen e të gjitha mjeteve juridike dhe procedurave të mëtejshme të parashikuara ndaj aktgjykimit të 16 shtatorit 2026, në koordinim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës dhe ekipet mbrojtëse të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit?

A do të angazhojë Qeveria, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të Kosovës dhe ekipet mbrojtëse, ekspertizë të posaçme juridike shqiptare dhe ndërkombëtare për shqyrtimin e aktgjykimit, vlerësimin e arsytimit juridik dhe të vlerësimit të provave, si dhe për identifikimin e çdo mjeti juridik dhe procedural që

Begaj dekreton rrokadën në qeveri/
Firmos shkarkimin e Lamallarit,
emërimin e Ervin Demos, 'shkrijten e 2
ministrive në 1'

Diaspora ngrihet sot në protesta në
mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

'Ndërkombëtarët s'kanë ndikuar te
politikanët', Gecaj: Ka patur presion për
çarmatosjen e UÇK

parashikohet nga e drejta ndërkombëtare me qëllim rrëzimin e tij?

2. MBROJTJA E INTERESIT TË DREJTPËRDREJTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Çfarë masash konkrete do të ndërmarrë Qeveria për të garantuar mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, në çdo aspekt të çështjes, që lidhet me territorin, institucionet, shtetasit, autoritetet apo veprimtarinë e Republikës së Shqipërisë?

A do të ndërmarrë Qeveria një nisëm të posaçme institucionale për evidentimin, verifikimin dhe dokumentimin e plotë të çdo reference që lidhet me territorin ose institucionet shqiptare në aktgjykim dhe në materialet e çështjes, si dhe për vlerësimin e nevojës për paraqitjen, nëpërmjet kanaleve dhe procedurave të përshtatshme, të dokumenteve, të dhënave ose materialeve arkivore që mund të jenë relevante për sqarimin e fakteve të pretenduara?

3. MEKANIZMI I PËRHERSHËM I KOORDINIMIT SHQIPËRI-KOSOVË

A do të propozojë dhe krijojë Qeveria një mekanizëm të posaçëm dhe të qëndrueshëm koordinimi ndërmjet institucioneve kompetente të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me përfshirjen e ekspertëve juridikë, diplomatikë dhe institucionalë, për ndjekjen e zhvillimeve të çështjes dhe koordinimin e veprimeve në planin juridik, diplomatik dhe institucional?

Si do ta konkretizojë Qeveria angazhimin e shprehur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë për të kontribuar në "korrigjimin e kësaj padrejtësie në rrugë institucionale" dhe cilat institucione do të ngarkohen me përgjegjësinë për zbatimin e këtij angazhimi?

4. VEPRIMI DIPLOMATIK DHE MBROJTJA E INTERESAVE TË KOSOVËS

Çfarë nisme dhe veprimesh diplomatike do të ndërmarrë Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në koordinim me institucionet e Republikës së Kosovës, në të gjitha institucionet ndërkombëtare ku Shqipëria është anëtare, përfshirë NATO-n, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillin e Evropës?

A do të vijojë Qeveria, në përputhje me deklaratën unanime të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, të kërkojë në forumet ndërkombëtare përkatëse hetimin, dokumentimin dhe vendosjen e plotë të drejtësisë për krimet e kryera gjatë regjimit të Slobodan Miloševićit, përfshirë krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit, si dhe të kërkojë që përgjegjësit të mbajnë përgjegjësi penale sipas së drejtës ndërkombëtare?

Çfarë veprimesh diplomatike dhe institucionale do të ndërmarrë Qeveria për të kundërshtuar çdo përpjekje të Serbisë për instrumentalizimin politik të këtij procesi, për relativizimin e krimeve të kryera gjatë regjimit të Miloševićit ose për cenimin e pozitës ndërkombëtare, legjitimitetit dhe shtetësisë së Republikës së Kosovës?

5. PLAN VEPRIMI, BURIME FINANCIARE DHE LLOGARIDHËNIE PARA KUVENDIT

A do të hartojë Qeveria një plan të posaçëm veprimi ndërinstitutional për ndjekjen e pasojave dhe zhvillimeve të mëtejshme të çështjes, ku të përcaktohen qartë masat juridike, diplomatike dhe institucionale, institucionet përgjegjëse, afatet e zbatimit dhe mënyrat e koordinimit me institucionet e Republikës së Kosovës, dhe a do t'ia paraqesë këtë plan për miratim Kuvendit të Republikës së Shqipërisë?

A do të ndërmarrë Qeveria, në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi dhe procedurat buxhetore, nismat e nevojshme për parashikimin e një zëri ose fondi të posaçëm në Buxhetin e Shtetit për mbështetjen financiare të veprimeve dhe procedurave ligjore që mund të ndërmerren në vijim të aktgjykimit, përfshirë mbështetjen e ndjekjes së mjeteve juridike dhe të mbrojtjes ligjore të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit, në koordinim me institucionet kompetente të Republikës së Kosovës dhe ekipet e tyre mbrojtëse?

A do t'ia paraqesë Qeveria Kuvendit një raport të plotë mbi masat e ndërmarra, burimet e angazhuara, rezultatet e veprimeve juridike dhe diplomatike dhe mekanizmat e koordinimit me Republikën e Kosovës, duke garantuar transparencë dhe llogaridhënie parlamentare për zbatimin e këtij angazhimi?

Kjo interpelancë kërkon të qartësojë nëse pas qëndrimit unanim të Kuvendit do të ketë edhe një veprim konkret të shtetit shqiptar.

Kuvendi e ka shprehur qartë qëndrimin e tij se lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë për lirinë dhe çlirimin e Kosovës; një aktgjykim nuk mund të rishkruajë historinë e një populli; krimet e regjimit të kasapit të Ballkanit, Milošević, nuk mund të relativizohen; dhe mjetet juridike duhet të ndiqen deri në fund.

Tashtë kërkohet që këto qëndrime të mos mbeten vetëm në nivel deklarativ.

Kërkohet veprim konkret, ligjor, diplomatik, institucional dhe i mirëkoordinuar me Republikën e Kosovës.

Republika e Shqipërisë duhet të përdorë të gjitha instrumentet që i njeh e drejta ndërkombëtare për të mbrojtur interesat e saj, për të mbështetur institucionet e Kosovës dhe për të garantuar që çdo çështje që prek drejtpërdrejt Shqipërinë dhe interesin kombëtar, të trajtohet me seriozitetin, ekspertizën dhe përgjegjësinë që kërkon një çështje e kësaj rëndësie.

Për këto arsye, kërkohet zhvillimin e një interpelance urgjente me Kryeministrin e Republikës së Shqipërisë.

Me respekt

Deputeti

TEDI BLUSHI

© SYRI.net

Lexo edhe:



Vrasja në Sarandë/ Balliu: Krimi ka dalë jashtë kontrollit, problemi është Edi Rama



Boçi: Largimi i David Nikollit zbulon realitetin e sportit shqiptar, Federata dhe ministria të mbajnë përgjegjësi



Atentati në Sarandë/ 'Kjo s'është më çështje statistikash kriminaliteti', Zhupa: Dështim i sigurisë publike

TË NGJASHME



'Rama bllokoi rezolutën për gjenocidin serb në Kosovë', Shehu: Ta miratojmë me urgjencë, për nder të Parlamentit



Zgjedhjet në Landin e Berlinit dhe Mecklenburg – Vorpommern, 'prova e zjarrit' për unitetin e CDU së Merz



'Pozita e Ballukut është rënduar – Gjekmarkaj: SPAK të kërkojë sërish arrestimin e saj, të shkohet edhe tek 'Perandori'



'Divjaka bashki!' Qytetarët sërish në shesh, në ditën e 51-të të protestës



Noka: Rama lidhi Ron Yeffet me Ergys Agasin dhe Klodian Allajbeun!



Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit nisin marshimin në rrugët e Tiranës



VIDEO / Protestuesi: Më 8 tetor tek Kuvendi! S'do lejojmë Edi Ramën të shkrijë bashkitë

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net